



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

FOL



**PROGRAMI PËR FUQIZIMIN
E SISTEMIT TË DREJTËSISË
MONITORIMI I PUBLIKIMIT
TË AKTGJYKIMEVE**

PROGRAMI PËR FUQIZIMIN
E SISTEMIT TË DREJTËSISË
MONITORIMI I PUBLIKIMIT
TË AKTGJYKIMEVE

PROGRAMI I USAID për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë është një aktivitet pesë vjeçar i sundimit të ligjit në Kosovë si vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme të USAID për të avancuar sundimin e ligjit në Kosovë dhe të siguroj që sistemi i drejtësisë operon në mënyrë profesionale, efikase dhe llogaridhënese. Programi fokusohet në promovimin e sistemit të drejtësisë bazuar në standardet më të larta të pavarësisë, paanësisë, integritetit, llogaridhënies, transparencës dhe në mbështetje të funksionimit dhe integritetit të strukturave gjyqësore në komunat në veri. Fuqizimi i efikasitetit dhe efektshmërisë në administrimin e gjyqësorit dhe ofrimit të shërbimeve cilësore. Përmes USAID, Programi për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë ndihmon Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe gjykatat në konsolidimin e rezultateve, në efektshmërinë, dhe menaxhimin e tyre.

LËVIZJA FOL me mbështetjen e Programit të USAID-it për Fuqizim të Sistemit të Drejtësisë (USAID/JSSP) dhe në partneritet me BIRN Kosova, janë duke e zbatuar projektin “Kërkimi i Transparencës në Sistemin Gjyqësor të Kosovës”. Në bashkëpunim të ngushtë me USAID/JSSP, përmes këtij projekti, FOL dhe BIRN synojnë të përmirësojnë efikasitetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë, dhe rritjen e besimit publik në sistemin gjyqësor.

Ky raport monitorues ka për qëllim të paraqes gjendjen aktuale të publikimit të aktgjykimeve duke pasur parasysh disa elemente bazë, të cilat duhet të jenë në harmoni me ligjet, rregulloret si dhe udhëzimet administrative, të cilat janë në fuqi. Po ashtu përmes këtij raporti synojmë të forcojmë edhe më tej sistemin gjyqësor për të promovuar edhe më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efikasitet të punës së gjykatave përmes publikimit sa më të madh të aktgjykimeve.

Ky raport është realizuar me përkrahjen e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e Lëvizjes FOL dhe jo domosdoshmërisht reflekton këndvështrimet e Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Bashkëpunim Ndërkombëtar apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

I gjithë monitorimi i Lëvizjes FOL është mbështetur në shkallën e përputhshmërisë së aktgjyqimeve me Ligjin për Gjykatat, me Udhëzimin Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjyqimeve të Plotfuqishme, si dhe me Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjyqimeve. Nga janari i vitit 2019 ka hyrë në fuqi legjislacioni i ri, i cili lejon publikimin e aktgjyqimeve jo të plotfuqishme. Ky ndryshim ligjor ka kontribuar në rritjen e numrit të publikimit të aktgjyqimeve nga degët dhe nivelet e gjykatave të Republikës së Kosovës.


- Nga janari 2016 deri në prill 2019, gjykatat e Kosovës kanë publikuar mesatarisht rreth 250 aktgjyqime për muaj. Prej fillimit të monitorimit me 1 maj – 15 nëntor 2019, ky numër pothuajse është katërfishuar me rreth 1,000 aktgjyqime të publikuara për muaj.
- Tri gjykata të cilat prijnë me numrin e aktgjyqimeve të publikuara:
 1. Gjkata Themelore e Ferizajt (1,245)
 2. Gjkata e Apelit (1,176)
 3. Gjkata Themelore e Prizrenit (1,056)
- Përgjatë muajve të monitorimit, Gjkata Themelore e Mitrovicës (715) dhe ajo e Gjakovës (704) kanë shënuar rritje të vazhdueshme në publikimin e aktgjyqimeve.
- Gjkata Supreme (314), Gjkata Themelore e Prishtinës (674), Pejës (504), dhe Gjilanit (221) kanë publikuar më pak aktgjyqime krahasuar me gjykatat e tjera.
- Degët e gjykatave me më së shumti publikime janë dega e Kaçanikut (215), Istogut (172), dhe Leposaviqit (145).
- Numri i gjyqtarëve që kanë aktgjyqime të publikuara është rritur për rreth 75% gjatë gjashtë muajve të kaluar. Përderisa në muajin maj 91 gjyqtarë publikuan aktgjyqime, në nëntor ky numër u rrit në 159 gjyqtarë.
- Gjatë periudhës monitoruese, Këshilli Gjyqësor i Kosovës për herë të parë që nga viti 2016, ka filluar të promovojë publikimin e aktgjyqimeve me vetiniciativë.

Lëvizja Fol para fillimit të monitorimit ka nxjerrë numrin e publikimit të aktgjyqimeve në të gjitha gjykatat dhe degët e tyre për periudhën janar 2016 – prill 2019, ku del të jenë publikuar gjithsej **10,186 aktgjyqime**, apo mesatarisht rreth **250 aktgjyqime** për muaj.

Publikimi i aktgjyimeve Janar 2016 -Prill 2019	2016	2017	2018	Prill 2019
Gjykata Supreme	77	54	272	219
Gjykata e Apelit	67	376	521	224
Gjykata Themelore Prishtinë	68	508	1110	200
Gjykata Themelore Ferizaj	125	657	650	56
Gjykata Themelore Prizren	102	223	1291	235
Gjykata Themelore Gjakovë	18	264	444	369
Gjykata Themelore Pejë	7	131	198	37
Gjykata Themelore Mitrovicë	0	8	604	120
Gjykata Themelore Gjilan	169	448	330	4
Totali për Gjykatë	633	2669	5420	1464

Totali i përgjithshëm 10,186


Periudha monitoruese, e cila fillon me 1 maj 2019 deri më 15 nëntor tregon se janë publikuar **6,611 aktgjykime**, apo **1,020 aktgjykime** për muaj.



GJETJET NGA MONITORIMI I PUBLIKIMIT TË AKTGJYKIMEVE

Pjesa më e madhe e aktgjykimeve të publikuara gjatë periudhës monitoruese janë të natyrës penale, respektivisht **4,479 aktgjykime**, duke u pasuar nga **1,890 aktgjykime** të natyrës civile, **133 aktgjykime** të natyrës administrative dhe **109** të natyrës ekonomike.

Natyra e lëndëve të publikuara për periudhën 1 maj - 15 nëntor 2019



Nga **6,611 aktgjykime** të publikuara gjatë kësaj periudhe, **60 aktgjykime** janë për vepra penale të korrupsionit, **62 aktgjykime** që kanë të bëjnë me dhunë dhe barazi gjinore, dhe **21** prej tyre me vepra penale të krimit të organizuar.

Natyra e veprave penale të publikuara për periudhën 1 maj - 15 nëntor



Gjatë periudhës monitoruese janë identifikuar **154 aktgjykime** të pa-anonizuara. Gjendje relativisht e mirë krahasuar me mungesën e resurseve njerëzore, në këtë rast aludohet në bashkëpunëtorët profesional, të cilët e kanë barrën kyçe për anonimizim. Ky numër në 2 muajt e fundit të monitorimit tetor - nëntor ka rënë në **0**, meqë kanë ndihmuar shumë praktikantët/ studentët e angazhuar të kryejnë punën praktike në gjykata.

Respektimi i anonimizimit të aktgjykimeve gjatë publikimit për periudhën 1 maj - 15 nëntor




Zbatimi i Vendimit për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve gjatë periudhës monitoruese mund të thuhet se ka hasur në vështirësi. Nga numri total prej **6,611 i aktgjykimeve** të publikuara, më tepër se gjysma, përkatësisht **3,856 aktgjykime** janë publikuar duke mos e respektuar këtë vendim.

Përdorimi i Shabllonit të Aktgjykimeve nga Gjykatat

Nuk është aplikuar
58%

Është aplikuar
42%



PËRDORIMI I GJUHËVE

Lëvizja FOL gjatë monitorimit ka evidentuar se nga **6,611 aktgjykime** të publikuara, vetëm **600** prej tyre janë të publikuara në gjuhën serbe, ndërsa **6,011** kanë qenë në gjuhën shqipe.

Përdorimi i gjuhëve



Monitorimi i Lëvizjes FOL nxjerr në pah edhe gjyqtarët më aktiv në publikimin e aktgjykimeve. Gjyqtarët me më së shumti publikime:


Gjyqtarët me më së shumti aktgjykime të publikuara, maj - nëntor 2019



GJYKATA SUPREME

- Nga 314 aktgjykime të publikuara, Gjykata Supreme ka publikuar vetëm 1 aktgjykim për rastet e korrupsionit, 3 aktgjykime të krimit të organizuar dhe vetëm 1 me bazë në dhunën gjinore.
- Vetëm 36 aktgjykime janë të publikuara duke përdorur formën standarde të shabllonit të aktgjykimeve.
- Nga 314 aktgjykime të publikuara, vetëm 17 prej tyre janë të pa-anonimizuara.
- Gjykatës Supreme iu janë dashur mesatarisht 130 ditë kohë për të publikuar një aktgjykim, që bie ndesh me afatin ligjor prej 60 ditësh.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Supreme | maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA E APELIT

- Nga 1,176 aktgjykime të natyrës penale, 20 aktgjykime janë të natyrës së korrupsionit, 6 me bazë në dhunë gjinore, si dhe 4 të krimit të organizuar.
- Gjykata e Apelit nuk e ka publikuar asnjë aktgjykim në formë të standardizuar.
- Nga 1,176 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë, vetëm 18 prej tyre janë publikuar të pa-anonimizuara.
- Kësaj gjykate iu janë dashur mesatarisht 54 ditë për të publikuar një aktgjykim, që tregon se kjo gjykatë qëndron më së miri sa i përket respektimit të afatit ligjor prej 60 ditësh.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata e Apelit 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E FERIZAJT

- Nga 1,245 aktgjykime të publikuara, 7 janë të evidentuara si lëndë të korrupsionit, 34 me bazë në dhunë gjinore.
- Gjykata Themelore e Ferizajt i ka të anonimizuar të gjitha aktgjykimet e publikuara.
- Gjykata Themelore e Ferizajt ka aplikuar Shabllonin e Aktgjykimeve në 916 aktgjykime (74%) të publikuara, kundrejt 329 të cilat janë jashtë këtij shablloni.
- Sa i përket respektimit të afatit prej 60 ditësh për publikimin e aktgjykimeve në ueb-faqe, gjatë kësaj periudhe monitoruese është vërejtur se kësaj gjykate i janë dashur mesatarisht 85 ditë për publikimin e tyre.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Ferizajt së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT

- Nga 1,056 aktgjykime të publikuara, 3 janë identifikuar të natyrës së korrupsionit dhe 7 të krimit të organizuar.
- Nga 1,056 aktgjykime, 64 prej tyre janë të pa-anonimizuara.
- Gjykata Themelore e Prizrenit ka aplikuar shabllonin në 583 aktgjykime, nga 1,056 sa ka publikuar në total.
- Gjykatës së Prizrenit i janë dashur mesatarisht 90 ditë për publikim të aktgjykimeve në ueb-faqe, llogaritur nga data e shpalljes së tyre.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Prizrenit së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

- Nga 715 aktgjykime të publikuara, 3 aktgjykime janë të korrupsionit dhe 7 me bazë në dhunë gjinore.
- Gjatë periudhës monitoruese nuk kemi hasur në asnjë aktgjykim të pa-anonimizuar.
- Gjykata e Mitrovicës ka aplikuar shabllonin për publikim të aktgjykimeve në 309 aktgjykime.
- Në këtë gjykatë, mesatarja e publikimit të aktgjykimeve në ueb-faqe pas shpalljes së tyre është 190 ditë, numër ky që dukshëm bie ndesh me afatin e përcaktuar me ligj.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Mitrovicës së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E GJAKOVËS

- Prej 704 aktgjykimeve, Gjykata Themelore e Gjakovës nuk ka publikuar asnjë aktgjykim të korrupsionit, për veprën penale dhunë me bazë gjinore ka publikuar 4 aktgjykime, ndërsa për krim të organizuar vetëm 1 aktgjykim.
- Gjykata Themelore e Gjakovës prej 704 aktgjykimeve, 14 prej tyre i ka publikuar të pa-anonimizuara.
- Gjykata Themelore e Gjakovës e ka zbatuar Vendimin për Standardizimin e Formave të Aktgjykimeve në 521 aktgjykime nga 704 në total.
- Për shkak të problemeve teknike shkaktuar nga zyrtarët përgjegjës për publikim të aktgjykimeve, ka qenë e pamundur të nxjerrim kohën mesataren për publikimin e aktgjykimeve në këtë gjykatë.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Gjakovës së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

- Nga 676 aktgjykime të publikuara nga kjo gjykatë, 23 janë të veprave penale të korrupsionit, 3 janë me bazë në dhunë gjinore dhe 4 nga to janë për krim të organizuar.
- Nga 676 aktgjykime, vetëm 197 prej tyre janë të publikuara sipas Shabllonit për Publikim të Aktgjykimeve.
- Kjo gjykatë ka publikuar vetëm 16 aktgjykime të pa-anonimizuara.
- Në këtë gjykatë mesatarja për publikim të aktgjykimeve është mbi 160 ditë.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Prishtinës së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E PEJËS

- Nga 504 aktgjykime, 1 aktgjykim është i korrupsionit, 3 të veprës penale dhunë me bazë gjinore dhe 3 krim i organizuar.
- Gjykata Themelore e Pejës, nga 504 aktgjykime të publikuara gjithsej, vetëm 14 i ka publikuar të pa-anonizuara.
- 305 aktgjykime prej 504 janë publikuar duke përdorur shabllonin e aktgjykimeve.
- Mesatarja për publikim të aktgjykimeve nga kjo gjykatë është rreth 140 ditë, duke tejkaluar dukshëm afatin kohor prej 60 ditësh.


Publikimi i aktgjykimeve nga Gjykata Themelore e Pejës së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



GJYKATA THEMELORE E GJILANIT

- Nga 221 aktgjykimet e publikuara, asnjë aktgjykim nuk është publikuar që ka të bëjë me korrupsionin, dhunën në bazë gjinore apo krim të organizuar.
- Sa i përket zbatimit të Udhëzimit Administrativ për Anonimizimin e Aktgjytimeve, nga të gjitha aktgjykimet e publikuara, vetëm 15 prej tyre kanë qenë të pa-anonimizuara.
- Prej 221 aktgjytimeve të publikuara, në 162 prej tyre është zbatuar forma e publikimit të aktgjykimit.
- Gjykatës Themelore të Gjilanit i janë dashur mesatarisht 180 ditë për publikimin e aktgjytimeve, nga dita e shpalljes së tyre.

Publikimi i aktgjytimeve nga Gjykata Themelore e Gjilanit së bashku me degët e saj 1 maj - 15 nëntor 2019



REKOMANDIME

- 1 Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të caktoj në secilën gjykatë zyrtarë për informim.
- 2 Gjykata Themelore e Mitrovicës duhet të i'u siguroj kyçje në internet dy degëve të saj, Leposaviqit dhe Zubin Potokut.
- 3 Gjykatat e Kosovës duhet të zbatojnë të gjitha rregulloret dhe vendimet e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, duke e përfshirë këtu edhe vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për Standardizimin e Formave të Aktgjytimeve.
- 4 Të përditësohet ueb portali i KGJK-së me lajme ditore dhe me njoftime të rëndësishme për publikun.
- 5 Ngritje të kapaciteteve për zyrtarët përgjegjës për publikimin e aktgjytimeve.
- 6 Çdo aktgjykim i publikuar duhet të kthehet në formatin PDF.
- 7 Çdo aktgjykim para publikimit duhet të rishikohet nga Zyrtarët për Informim sa i përket harmonizimit të aktgjykimit me Udhëzimin Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjytimeve të Plotfuqishme.
- 8 Aktgjykimi para publikimit duhet të shikohet se në cilën gjuhë është duke u publikuar, në mënyrë që të mos publikohet aktgjykimi i njëjte në secilën gjuhë.
- 9 Unifikimi i numrit të rastit. Secili rast të ketë numrin e tij unik, e jo ta ndaj me një rast të një natyre krejt tjetër.
- 10 Të shënohen në të gjitha aktgjykimet parashitesat e numrave arkivorë, që kanë për qëllim të tregojnë se për çfarë lënde bëhet fjalë (psh. rast penal, civil etj).

